

Nr. 1355 Prot.

Datë 02.06.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
VLORË

Nr.318 Akti (L.Sinollari)

Vlorë, më 27.05.2025

SHPALLJE – PUBLIKE

Bazuar në nenin 140 të Kodit të Proçedurës Penale po ju dërgojmë për shpallje publike të vendimit penal **nr.174**, date 25.04.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Dëftesa e komunikimit është kthyer nga shërbimi postar me shënimin “**Larguar**” për te pandehurin “**Xhonatan Mersin Nano**” sipas adresës së cituar në aktet e dosjes:

Adresa: Banues ne fshatin Palavli, Delvine.

Një kopje e kësaj shpallje afishohet pranë :

1. Këndit të afishimit të Gjykatës së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.
2. Faqes elektronike të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.
3. **Bashkia Delvine, per te pandehurin “Xhonatan Mersin Nano”.**
4. **Një kopje e kësaj shpallje të kthchet e konfirmuar sipas ligjit.**

Nr. _____ Protokolli

Data e Marrjes _____

Vula



SEKRETARE
Malvina Bajrami





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM VLORË

Nr. 318 Regj.Them.
Datë 16.04.2025 Regj.

Nr.Vendimi 174
Datë vendimi 25.04.2025

VENDIM

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"
(Për miratimin e urdhrit penal)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë e përbërë nga:

GJYQTARE: LIRËZA SINOLLARI

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Marinela Bonjaku**, në Vlorë, sot më datë **25.04.2025**, i dha fund shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale Nr. 318 Regj.Them., që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, përfaqësuar nga Prokurore Erida Visoçi.

I PANDEHUR: **Xhonatan Nano**, i biri i Mersin dhe i Haxhire, i datëlindjes 10.03.1997, lindur në Vlorë dhe banues në Delvinë, fshati Palavli, me arsim 12 klasë, me gjendje civile beqar, me gjendje gjyqësore i padënuar, me shtetësi shqiptare, me Nr.Personal J70310054E.

ME OBJEKT: Miratimin e Urdhrit Penal datë 07.04.2025, për procedimin penal nr. 199, të vitit 2025, me të pandehur: Xhonatan Nano, i biri i Mersin dhe Haxhire, lindur më 10.03.1997, në Vlorë, banues në Delvinë, fshati Palavli, shtetësia shqiptare, me numër personal J70310054E, për kryerjen e veprës penale "Plagosja e lehtë me dashje", parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Neni 24/5 dhe 406/a e vijës të Kodit të Procedurës Penale.

VIKTIMA: **Klaudjo Qofiti**, i biri i Sokol dhe i Arta, i datëlindjes 29.04.2004, lindur në Përmet dhe banues në fshatin Shën Vasil Himarë, me arsim N klasë, me gjendje civile beqar, me gjendje gjyqësore i padënuar, me shtetësi shqiptare, me Nr.Personal K40929045B.

Si shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes dhe çmoi dhe vlerësoi në tërësi aktet e paraqitura nga organi i akuzës:



VËREN SE:

I. Procedura.

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka paraqitur pranë kësaj gjykate kërkesën për "Miratimin e Urdhrit Penal datë 07.04.2025, për procedimin penal nr. 199, të vitit 2025, me të pandehur: Xhonatan Nano, i biri i Mersin dhe Haxhire, lindur më 10.03.1997, në Vlorë, banues në Delvinë, fshati Palavli, shtetësia shqiptare, me numër personal J70310054E, për kryerjen e veprës penale "Plagosja e lehtë me dashje" parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal."
2. Gjykata, bazuar në nenin 69 të K.Pr.Penale çmoi se çështja i përket juridiksionit gjyqësor dhe sipas neneve 74 dhe 76 të K.Pr.Penal gjykimi i saj është në kompetencën lëndore dhe tokësore të kësaj gjykate. Në referim të nenit 13, pika 2, shkronja "d" të K.Pr.Penale, u procedua me gjykimin e çështjes me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar.
3. Gjithashtu, Gjykata, në vështrim të neneve 15, 16, 17, 18 të K.Pr.Penale, çmoi se nuk ekzistojne shkaqe papajtueshmërie ose përjashtimi nga gjykimi i çështjes.
4. Bazuar në nenin 406/b të K.Pr.Penale sipas të cilit: "Gjykata shqyrton kërkesën pa praninë e palëve dhe vendos brenda dhjetë ditëve nga depozitimi i saj", Gjykata caktoi seancën për shqyrtimin e kërkesës, pa praninë e palëve, brenda 10 ditëve nga regjistrimi i kërkesës, ndërkohë që vendimi do t'u njoftohet palëve sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

II. Rrethanat e faktit.

5. Gjykata, duke vlerësuar të gjitha aktet dhe provat të grumbulluara në fazën e hetimeve paraprake dhe duke i vlerësuar ato në tërësinë e tyre çmon të provuar faktin si më poshtë:
6. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, mbi bazën e materialeve hetimore të referuara nga Komisariati i Policisë Himarë, ka regjistruar procedimin penal Nr.199, datë 10.02.2025, për veprën penale "Plagosja e lehtë me dashje" parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Xhonatan Nano.
7. Nga tërësia e veprimeve hetimore të kryera dhe provave të administruara në kuadër të këtij procedimi penal rezultoi e provuar se: Më datë 06.01.2025 është paraqitur në Komisaratin e Policisë Himarë shtetasi Klaudjo Qofiri dhe ka paraqitur ankim ndaj shtetasit Xhonatan Nano.
8. Shtetasi Klaudjo Qofiri ka parashtruar faktin se me datë 06.01.2025, rreth orës 19:00, ka parkuar makinën e tij në vendin e quajtur "Volloder". Ai ka deklaruar se ndërkohë që qëndronte në makinë, i është afruar shtetasi Xhonatan Nano me motor dhe i ka kërkuar 1000 që i kishte borxh. Shtetasi Klaudjo Qofiri ka sqaruar se ka mbushur makinën me benzinë në karburantin ku punon shtetasi Xhonatan Nano. Ankuesi i është përgjigjur se nuk do t'i japë paratë për shkak të një debati para një jave. Shtetasi Klaudjo Qofiri ka deklaruar se shtetasi Xhonatan Nano e ka qëlluar me pëllëmbë nga xhami i makinës e më pas i ka rënë në kokë me kokoren e motorit,

duke i çarë ballin.

9. Shërbimet e policisë kanë kryer këqyrjen fizike të shtetasit Klaudjo Qofiri, nga ku është konstatuar se ka një dëmtim në pjesën e ballit, në krahun e majtë, mbi sy rreth 3 centimetra, me heqje lëkure dhe rrjedhje si ajo e gjakut. Në pjesën e bluzës konstatohet një e grisur në pjesën e qafës. Këqyrja është shoqëruar me tabelën fotografike nr. 4, datë 06.01.2025. Gjithashtu, është bërë këqyrja fizike e shtetasit Xhonatan Nano, nga ku nuk ka rezultuar të ketë dëmtime apo shenja dhune. Këqyrja është shoqëruar me tabelën fotografike nr. 5, datë 06.01.2025.
10. Në lidhje me dëmtimet e marra nga shtetasit Klaudjo Qofiri është marrë vendim ekspertimi mjeko-ligjor dhe me aktin mjeko-ligjor nr. 011/d, datë 24.01.2025 për shtetasin Klaudjo Qofiri është arritur në konkluzionet se: *“1. Tek i dëmtuari konstatohen: Mbetje plage (cikiatrice) me karakteristikat dhe lokalizimet e përshkruara në akt. 2. Këto dëmtime janë shkaktuar me mjet të fortë mbretës. 3. Dëmtimet e mësipërme hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve të cilat sjellin humbjen e përkohshme të aftësisë për punë në masën mbi 9 (nëntë) ditë në momentin e shkaktimit të tyre.”*
11. Shtetasi Xhonatan Nano ka deklaruar se me shtetasin Klaudjo Qofiri ka patur marrëdhënie shoqërore. Ai ka sqaruar se shtetasi Klaudjo Qofiri ka shkuar në karburantin ku ai punon dhe ka mbushur makinën me benzinë me lekë borxh. Ditën e ngjarjes ai i ka kërkuar shumën prej 1000 lekë që i kishte borxh dhe shtetasi Klaudjo Qofiri i ka thënë se nuk do t'ia jepte dhe e ka ofenduar e më pas janë konfliktuar fizikisht.
12. Mbi bazën e këtyre fakteve, Prokuroria ka marrë si të pandehur shtetasin Xhonatan Nano, për kundërvajtjen penale *“Plagosja e lehtë me dashje”*, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, dhe me datë 07.04.2025 ka nxjerrë urdhrin penal për deklarimin fajtor të të pandehurit Xhonatan Nano dhe dënimin e tij me 200.000 lekë gjobë, e cila të paguhet me 4 (katër) këste nga 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj, pasi vendimi gjyqësor të marrë formë të prerë.
13. Sa më sipër, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë i është drejtuar kësaj gjykate më kërkesën me objekt si në hyrje të këtij vendimi.

III. Arsyetimi ligjor.

14. Gjykata, pasi mori në analizë juridike rrethanat e faktit dhe të ligjit, duke i çmuar ato në harmoni me njëra-tjetrën, arrin në përfundimin se kërkesa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për miratimin e urdhrin penal datë 07.04.2025, për procedimin penal nr. 199 të vitit 2025, me të pandehur Xhonatan Nano, akuzuar për kryerjen e veprës penale *“Plagosja e lehtë me dashje”*, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, është e bazuar në prova e në ligj e si e tillë duhet pranuar.
15. Kodi i Procedurës Penale, i ndryshuar me Ligjin Nr.35/2017, ka parashikuar si formë të gjykimit të posaçëm edhe Gjykimin për shqyrtimin e kërkesës së prokurorit për miratimin e urdhrin penal. Konkretisht, në nenin 406/a të K.Pr.Penale, janë parashikuar në mënyrë të qartë elementët formalë që duhet të përmbajë kërkesa për miratimin e urdhrin penal. Kjo dispozitë ligjore parashikon se: *“Kur i pandehuri akuzohet për kryerjen e një kundravajtjeje penale,*

brenda tre muajve nga regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale, prokurori nxjerr urdhër penal të arsyetuar për caktimin e dënimit dhe i kërkon gjykatës miratimin e tij, në rastet kur çmon se nuk duhet të zbatohet dënimi me burgim. 2. Në urdhrin penal prokurori cakton dënimin kryesor me gjobë. Sipas rastiit mund të caktojë edhe një ose më shumë dënime plotësuese. Në varësi të gjendjes ekonomike të të pandehurit, prokurori mund të urdhërojë që gjoba të paguhet me këste, duke caktuar edhe afatet e pagimit të tyre. 3. Dënimi me gjobë nuk mund të kalojë gjysmën e maksimumit që parashikon Kodi Penal për këtë lloj dënimi. 4. Në përfundim të hetimeve kërkesa për miratimin e urdhërit penal depozitohet në sekretarinë e gjykatës, së bashku me të gjitha aktet e fashikullit të hetimeve paraprake. Kërkesa për miratimin e urdhërit penal i njoftohet të pandehurit”.

16. Në interpretim të dispozitës së mësipërme, Gjykata vlerëson se kërkesa për miratimin e urdhrit penal duhet të përmbajë elementët formalë dhe thelbësore të kërkuara nga ligji procedural penal.

- Lidhur me elementët formalë.

17. Gjykata vlerëson se nga ana e prokurorisë janë respektuar parashikimet e nenit 406/a të K.Pr.Penale. Urdhri penal është nxjerrë brenda afatit tre mujor nga dita e regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale. Kërkesa është shoqëruar me të gjitha aktet dhe provat që përmban fashikulli i hetimit, sipas parashikimit të nenit 406/a pg. 4 i K.Pr.Penale. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, hetimet e kryera nga organi i prokurorisë janë të plota. Nga vlerësimi në tërësi i akteve të ndodhura në fashikullin e hetimeve paraprake, vlerësohet se organi i prokurorisë ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore në kuadër të grumbullimit të provave për të provuar faktin penal në ngarkim të të pandehurit Xhonatan Nano.

- Lidhur me elementët thelbësorë.

18. Nga interpretimi *a contrario* i nenit 406/c i K.Pr.Penale, i cili parashikon se: “1. Gjykata refuzon miratimin e urdhrit penal kur: a) ekziston njëri nga rastet e pushimit të akuzës ose çështjes; b) i pandehuri akuzohet për një vepër penale, për të cilën ligji nuk lejon zbatimin e urdhrit penal të dënimit; c) prokurori ka kërkuar një masë dënimi me gjobë ose një apo më shumë dënime plotësuese të papërshtatshme; ç) krijon bindjen se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet e hetimeve paraprake që i bashkëlidhen kërkesës për miratim.”, Gjykata vlerëson se elementët thelbësorë që duhet të plotësohen në rastin e miratimit të një urdhri penal janë:

19. **Së pari**, i pandehuri duhet të akuzohet për një vepër penale, për të cilën ligji lejon zbatimin e urdhrit penal. Nga leximi i nenit 89 të K.Penal rezulton se vepra penale “Plagosja e lehtë me dashje” përbën kundërvajtje penale, e cila dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Pra, kjo dispozitë parashikon ndër të tjera edhe dënimin me gjobë dhe për rrjedhojë, bën pjesë në kategorinë e atyre veprave penale për të cilat mund të nxirret urdhër penal nga organi i prokurorisë.

20. **Së dyti** çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet e hetimeve paraprake. Në analizë të

akteve të ndodhura në fashikullin hetimor në raport me nenin 128/a të K.Pr.Penale, i cili vendos mbi gjykatën detyrimin për kontrollin e vlefshmërisë dhe ligjshërisë së akteve të kryera gjatë hetimeve paraprake dhe konstatimin kryesisht të rasteve të pavlefshmërisë absolute të tyre, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk konstatohen akte absolutisht të pavlefshme, duke konkluduar se çështja mund të zgjidhet në gjëndjen që janë aktet.

21. **Së treti**, masa e dënimit kryesor me gjobë apo një ose disa dënime plotësuese, të kërkuara nga prokurori, duhet të jenë proporcionale dhe të përshtatshme. Për të vlerësuar përmbushjen e këtij elementi Gjykata vlerëson se në rastin konkret duhet të merren në analizë elementët e veprës penale "*Plagosja e lehtë me dashje*", parashikuar nga neni 89 i K.Penal. Kjo dispozitë parashikon se: "*Plagosja e kryer me dashje, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.*"
22. **Objekti** i kësaj vepre penale janë marëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar shëndetin e personit, paprekshmërinë e tij nga çdo dëmtim, të mbrojtura me legjislacionin penal nga veprimet kriminale.
23. **Nga ana objektive**, figura e veprës penale "*Plagosja e lehtë me dashje*" kryhet me anë të veprimeve aktive të kundërligjshme duke dëmtuar shëndetin dhe integritetin fizik të një personi tjetër.
24. Në rastin konkret rezulton e provuar se më datë 06.01.2025 është paraqitur në Komisaratin e Policisë Himarë shtetasi Klaudjo Qofiri dhe ka paraqitur ankim ndaj shtetasit Xhonatan Nano.
25. Shtetasi Klaudjo Qofiri ka parashtruar faktin se me datë 06.01.2025, rreth orës 19:00, ka parkuar makinën e tij në vendin e quajtur "Volloder". Ai ka deklaruar se ndërkohë që qëndronte në makinë, i është afruar shtetasi Xhonatan Nano me motor dhe i ka kërkuar 1000 që i kishte borxh. Shtetasi Klaudjo Qofiri ka sqaruar se ka mbushur makinën me benzinë në karburantin ku punon shtetasi Xhonatan Nano. Ankuesi i është përgjigjur se nuk do t'i japë paratë për shkak të një debati para një jave. Shtetasi Klaudjo Qofiri ka deklaruar se shtetasi Xhonatan Nano e ka qëlluar me pëllëmbë nga xhami i makinës e më pas i ka rënë në kokë me kokoren e motorit, duke i çarë ballin.
26. Shërbimet e policisë kanë kryer këqyrjen fizike të shtetasit Klaudjo Qofiri, nga ku është konstatuar se ka një dëmtim në pjesën e ballit, në krahun e majtë, mbi sy rreth 3 centimetra, me heqje lëkure dhe rrjedhje si ajo e gjakut. Në pjesën e bluzës konstatohet një e grisur në pjesën e qafës. Këqyrja është shoqëruar me tabelën fotografike nr. 4, datë 06.01.2025. Gjithashtu, është bërë këqyrja fizike e shtetasit Xhonatan Nano, nga ku nuk ka rezultuar të ketë dëmtime apo shenja dhune. Këqyrja është shoqëruar me tabelën fotografike nr. 5, datë 06.01.2025.
27. Në lidhje me dëmtimet e marra nga shtetasit Klaudjo Qofiri është marrë vendim ekspertimi mjeko-ligjor dhe me aktin mjeko-ligjor nr. 011/d, datë 24.01.2025 për shtetasin Klaudjo Qofiri është arritur në konkluzionet se: "1. Tek i dëmtuari konstatohen: *Mbetje plage (cikiatrice) me karakteristikat dhe lokalizimet e përshkruara në akt.* 2. *Këto dëmtime janë shkaktuar me mjet të fortë mbretës.* 3. *Dëmtimet e mësipërme hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve të cilat sjellin*

humbjen e përkohshme të aftësisë për punë në masën mbi 9 (nëntë) ditë në momentin e shkaktimit të tyre.”.

28. Shtetasi Xhonatan Nano ka deklaruar se me shtetasin Klaudjo Qofiri ka patur marrëdhënie shoqërore. Ai ka sqaruar se shtetasi Klaudjo Qofiri ka shkuar në karburantin ku ai punon dhe ka mbushur makinën me benzinë me lekë borxh. Ditën e ngjarjes ai i ka kërkuar shumën prej 1000 lekë që i kishte borxh dhe shtetasi Klaudjo Qofiri i ka thënë se nuk do t'ia jepte dhe e ka ofenduar e më pas janë konfliktuar fizikisht.
29. **Subjekti është i përgjithshëm.** Personi fizik që të konsiderohet subjekt i figurës së veprës penale, dhe si rrjedhojë të plotësojë kushtin paraprak për fajin dhe përgjegjësinë penale, duhet të plotësojë dy kritere ekskluzive ligjore (condicio sine qua non): *i) Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe ii) të jetë i përgjegjshëm për veprën penale në momentin e kryerjes së saj.* Në rastin konkret, i pandehuri Xhonatan Nano në kohën e kryerjes së veprës ka qenë madhor dhe i përgjegjshëm para ligjit, si rrjedhojë ai ka qenë i aftë të posedojë aftësi intelektuale dhe vulltative për të kuptuar dhe vlerësuar sjelljen e tij dhe t'a kontrollojë atë. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se i pandehuri Xhonatan Nano është subjekt i përgjegjshëm penalisht.
30. **Nga ana subjektive,** kjo vepër penale kërkon si formë faji dashjen. Në rastin konkret rezulton se i pandehuri Xhonatan Nano ka vepruar me dashje, duke ushtruar dhunë ndaj viktimës Klaudjo Qofiri.
31. Sa më sipër, rezulton e provuar **tej çdo dyshimi të arsyeshëm** se i pandehuri Xhonatan Nano, me veprimet e tij aktive, ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale *“Plagosja e lehtë me dashje”*, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal.
32. **Së katërti,** nuk duhet të ekzistojë ndonjëri nga rastet e pushimit të akuzës apo çështjes. Në sintezë të analizës së mësipërme, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ndodhemi në ndonjë nga rastet kur duhet të vendoset pushimi i çështjes apo i akuzës, duke e konsideruar të plotësuar edhe kushtin e fundit thelbësor të kërkuar nga ligji.

Lidhur me caktimin e llojit dhe masës së dënimit.

33. Dënimi penal në të drejtën penale kupton atë masë shtrënguese, që zbatohet nga shteti nëpërmjet Gjykatave, në bazë të ligjit, kundër personave fajtorë që kanë kryer vepër penale. Në këtë kuptim, është e domosdoshme që gjykata gjatë caktimit të tij, të udhëhiqet jo vetëm nga parimi i ligjshmërisë dhe domosdoshmërisë së dënimit, por njëkohësisht edhe nga parimi i dobishmërisë dhe individualizimit të tij. Konkretisht, në nenin 47 të K.Penal, sanksionohet se: *“Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese”.*
34. Në rastin konkret, organi i prokurorisë ka vlerësuar si masë dënimi të përshtatshme dhe

proporcionale me rrethanat tërësore të çështjes dënimit e të pandehurit Xhonatan Nano me 200.000 (dyqind mijë) lekë gjobë, për kryerjen e kundërvajtjes penale “*Plagosja e lehtë me dashje*”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, gjobë e cila do të paguhet në 4 (katër) këste mujore, nga 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj, pasi vendimi gjyqësor të marrë formë të prerë.

35. Sa i përket llojit dhe kufijve të dënimit në rastin konkret legjislatori në nenin 89 të K.Penal ka parashikuar në mënyrë alternative dy lloje dënimi dhe konkretisht dënimit me gjobë ose me burgim deri në një vit. Pra, dispozita e veçantë nuk ka parashikuar në mënyrë të shprehur kufirin minimal dhe maksimal të dënimit me gjobë. Ndërkohë që për sa i përket dënimit me burgim, ka parashikuar vetëm kufirin maksimal (deri në dy vjet). Në këto kushte, Gjykata vlerëson se për të përcaktuar kufijtë e dënimit me gjobë dhe kufirin minimal të dënimit me burgim, për veprën penale “*Plagosja e lehtë me dashje*”, duhet të referohet në dispozitat e pjesës së përgjithshme të Kodit Penal. Konkretisht, në nenin 32 të K.Penal, ku konkretisht parashikohet se: “*Për kundërvajtjet penale dënimi me burgim jepet për një kohë nga pesë ditë deri në dy vjet*”. Ndërkohë që në nenin 34 të K.Penal, parashikohet shprehimisht se: “*Për personat që kryejnë kundërvajtje penale, gjoba jepet nga 50.000 (pesëdhjetë mijë) deri në 3 (tre) milion lekë*”.
36. Si përfundim, Gjykata vlerëson se në lidhje me kundërvajtjen penale “*Plagosja e lehtë me dashje*”, parashikuar nga neni 89 i K.Penal, në kuadër të respektimit të parimit të individualizimit të dënimit, mund të jepet një dënim me gjobë nga 50.000 (pesëdhjetë mijë) deri në 3 (tre) milion lekë ose dënim me burgim nga pesë ditë deri në dy vjet.
37. Në interpretim të dispozitave të sipërcituara, Gjykata, çmon të vlerësojë këto elementë:
- **Llojin dhe kufijtë e dënimit të parashikuar në dispozitën konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal:** Neni 89 i K.Penal parashikon dënim me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet;
 - **Rrezikshmërinë e veprës penale** Për të interpretuar “*rrezikshmërinë e veprës penale*” është e nevojshme, që në kuadrin e praktikës gjyqësore dhe të një të “*drejte gjyqësore*” tashmë të formuar prej vitesh në traditën juridike të Republikës sonë, t’i referohemi në mënyrë orientuese Udhëzimit Nr.2, datë 14.03.1979 të Plenumit të Gjykatës së Lartë, i cili përmban vlera të pamohueshme interpretative, ku përcaktohen elementët individualizues dhe matës të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale. Këto element, në mënyrë të hapur listuese dhe orientuese, janë: a) **Objekti**; b) **Vendi**; c) **Koha**; d) **Gjendja në të cilën kryhet vepra penale**; e) **Nëse vepra penale është e përhapur në atë rreth**; f) **Rrethanat që kanë ndikuar në kryerjen e saj**. Në rastin konkret, vepra penale në ngarkim të të pandehurit nuk paraqet rrezikshmëri shoqërore pasi kategorizohet si kundërvajtje penale dhe ka marzh të ulët dënimi.
 - **Rrezikshmërinë e autorit të veprës penale:** Për interpretimin e “*rrezikshmërisë së autorit të saj*” është e nevojshme të përmendim disa elementë orientues për t’u mbajtur parasysh, që Udhëzimi i mësipërm identifikon si: a) **Gjendja sociale**; b) **Profesioni**; c) **Arsimimi**; d) **Gjendja familjare**; e) **Gjendja gjyqësore**. Interpretuar në harmoni të gjithë këto tregues që kanë lidhje të drejtëpëdrejtë me personalitetin dhe individualitetin që paraqet individi në shoqërinë tonë, japin konkluzionin se i pandehuri paraqet rrezikshmëri shoqërore të ulët ose të lartë. Prandaj, për gjykatën lind detyrimi që në çdo

çështje të analizojë faktorët apo tiparet e personalitetit të autorit të veprës penale. Në lidhje me këtë kriter, Gjykata në rastin konkret mban parasysh disa fakte. **Së pari:** personalitetin e të pandehurit, ku gjatë gjykimit u provua se ai ka nuk ka qenë i dënuar më parë. **Së dyti,** moshën e të pandehurit i cili është i vitlindjes 1997. Të gjitha këto fakte i krijojnë bindjen gjykatës se i pandehuri nuk paraqet rrezikshmëri të lartë e të theksuar shoqërore në raport me rrezikshmërinë e pakët që mbart vepra penale e parashikuar nga neni 89 i K.Penal.

- **Shkallën e fajit:** Vepra penale është kryer me dashje që është shkalla më e rëndë e fajësisë);
- **Rrethanat lehtësuese dhe rënduese.**

38. Në lidhje me rrethanat rënduese, neni 50 i K.Penal parashikon, në mënyrë shteruese, rrethanat që ndikojnë në rëndimin e pozitës së të pandehurit. Në rastin konkret, nuk u evidentua asnjë rrethanë e tillë.

39. Në lidhje me rrethanat lehtësuese, në dallim nga ato rënduese, neni 49 i K.Penal nuk parashikon një listë shteruese të rrethanave që mbahen parasysh nga gjykata dhe që justifikojnë lehtësimin e dënimit.

- faktin që i pandehuri nuk i është shmangur hetimit dhe gjykimit dhe ka qenë bashkëpunues;
- moshën e të pandehurit;

40. Në analizë tërësore të sa më sipër, Gjykata konkludon se në rastin konkret ndaj të pandehurit Xhonatan Nano duhet të caktohet dënimi me 200.000 (dyqind mijë) lekë gjobë për veprën penale "Plagosja e lehtë me dashje", parashikuar nga neni 89 i K.Penal, e cila do të paguhet në 4 (katër) këste mujore, secili në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj, pasi vendimi gjyqësor të marrë formë të prerë. Gjykata thekson se kjo masë dënimi, është një masë e përshtatshme për të pandehurin, në përputhje me veçoritë e tij dhe të veprës penale konkrete, si dhe me rrethanat në të cilat vepra penale është kryer, duke synuar ruajtjen e një raporti të drejtë mes ndëshkimit të fajtorit dhe mbrojtjes së shoqërisë. Gjykata çmon se dënimi i dhënë, do t'i shërbejë të pandehurit për edukimin e tij, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga e pandehuri, rehabilitimit të tij, si dhe parandalimit të përgjithshëm të këtyre veprave penale në shoqëri. Gjithashtu, Gjykata në caktimin e një masë të tillë dënimi ndaj të pandehurit mban parasysh edhe parimin se ashpërsia e një penalisiteti për një vepër penale të kryer, duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale me ashpërsinë e veprës penale. Në këtë kuptim. Gjykata konkludon se masa e dënimit e përcaktuar nga prokurori në urdhrin penal është vlerësuar në mënyrë të drejtë, të përshtatshme dhe proporcionale nga prokurori.

41. Në analizë të sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret plotësohen në mënyrë kumulative të gjitha elementët thelbësorë të kërkuar nga ligji për miratimin e urdhrin penal.

42. Në këto kushte, Gjykata, duke e vlerësuar kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për miratimin e urdhrin penal datë 07.04.2025 të nxjerrë për të pandehurin Xhonatan Nano, akuzuar për kryerjen e kundërvajtjes penale "Plagosja e lehtë me dashje", parashikuar nga neni 89 i K.Penal, si të bazuar në ligj e në prova, arrin në përfundimin se ajo duhet pranuar dhe urdhri penal duhet miratuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenet 406/a – 406/ç të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Pranimi e kërkesës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.
2. Miratimin e urdhrit penal datë 07.04.2025.
3. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Xhonatan Mersin Nano**, i datëlindjes 10.03.1997, për kryerjen e kundërvajtjes penale "*Plagosja e lehtë me dashje*", parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 200 000 (dyqind mijë) lekë gjobë.
4. Gjoha duhet të paguhet me 4 (katër) këste mujore, secili në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Pagesa e këstit të parë duhet të bëhet brenda 10 ditësh nga marrja formë të prerë e këtij vendimi.
5. Një kopje e këtij vendimi t'i komunikohet prokurores dhe të pandehurit.
6. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim nga i pandehuri në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë brenda 10 (dhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.


- U shpall në Vlorë, sot më datë 25.04.2025

SEKRETARE

MARINELA BONJAKU

GJYQTARE

LIRËZA SINOLLARI



Shpenzime gjyqësore

-Në fazën e hetimeve paraprake: 8000 lekë

-Në fazën e gjykimit:

-Njoftime: 120 lekë